



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 13, datë 18.10.2023

PËR

“MËNYRËN E PËRDORIMIN NGA AKEP TË KOMISIONIT QË DO TË PËRFITOHET, SI AGJENT TATIMOR PËR VITIN 2024”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Tomi Frashëri	Kryetar
Znj. Edlira Dvorani	Anëtar
Z. Armer Juka	Anëtar
Z. Bleron Dokle	Anëtar
Z. Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 18/10/2023, konform procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si agjent tatimor për vitin 2024;**

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 3 e nenit 114, pika 3, e nenit 117, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH” (**ligji9918/2008**);

2. Pika 4, e nenit 2, pika 3 e nenit 8, si dhe gërma e), e nenit 11, të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. (**ligji nr. 9975/2008**);
3. Pika 1.b) e nenit 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9920/2008**);
4. Pika 1 e nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar (**ligji 10296/2010**);
5. Pika 3 dhe pika 6 e Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe AKEP, nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar;
6. Seksioni 1 i Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 26, datë 04.09.2008 “Për Taksat kombëtare”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 27 datë 16.12. 2014.
7. VKD nr. 93, datë 10.12.2018 “Për vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përftuar nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare”,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacioni Shpjegues/Shoqërues i projektvendimit të përgatitur nga DBMF (**Relacioni**);
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, bazuar në legjislacionin që rregullon procedurat tatimore në RSH, është përcaktuar institucioni publik në rolin e Agjentit Tatimor, përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e të ardhurave nga tarifa për shërbimet e radiokomunikimit në llogaritë e drejtorive rajonale tatimore, për t’u transferuar më pas në Buxhetin e Shtetit, mbështetur kjo në nenin 11/e, të ligjit nr. 9975/2008.
2. Në vijim, si dhe referuar Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Kryetarit të KD-së së AKEP me nr.30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar, është përcaktuar niveli i tarifës së shërbimit të radiokomunikimit, si dhe komisionet përkatëse të përftuar nga AKEP në funksionin e agjentit tatimor për mbledhjen e tarifës për shërbimet e radiokomunikimit.

3. Në pikën 6 të Udhëzimit të sipërcituar, është përcaktuar se AKEP për shërbimet e kryera përfiton në masën 5% komision të vetë llogaritur prej tij, mbi vlerën e tarifave të llogaritura dhe arkëtuara, ndërkohë që transferon 95 % të vlerës në Buxhetin e Shtetit. Mbledhja dhe transferimi i tarifave dhe taksave në buxhetin e shtetit, është detyrë që e kryen agjenti tatimor, referuar përcaktimeve ligjore parashikuara në pikën 1.b), neni 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilave *agjenti tatimor është personi që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat.*
4. Në vëmendje të sa më sipër, AKEP me VKD nr. 93, datë 10.12.2018, “Për, vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përfutur nga AKEP në cilësinë e tij Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare”, ka sanksionuar ndër të tjera modalitetet dhe procedurat e përdorimit të këtij komisioni, duke konsideruar themelore tre kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi (**Ligji nr.9975/2008**).
5. Përgjegjësia e AKEP si Agjent Tatimor është e lidhur me zbatimin e detyrave të përcaktuara në pikën 4, të nenit 2, të ligjit nr. 9975, “Për taksat kombëtare”, të cilat në rastin konkret janë:
 - a. llogaritja e tarifës për shërbimin e radiokomunikimit;
 - b. arkëtimi i lyre;
 - c. transferimi në llogarinë e Buxhetit të Shtetit i të ardhurave të vjela nga arkëtimi tarifës.
6. Komisioni si Agjent Tatimor në masën 5 %, AKEP ka tagër ta vetëllogarisë në burim, pra menjëherë pas mbledhjes së tyre, si dhe duhet ta përdorë konform pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 9975 dhe pikës 1.3 seksioni I të Udhëzimit nr. 26, ku përcaktohet se komisionet e përfituara përdoren:
 - a. Në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
 - b. Në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
 - c. Për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.
7. Këshilli Drejtues i AKEP si organ drejtues ka të drejtë për të vendosur mënyrën, përdorimin me efikasitet dhe në bazë të nevojave duke marrë parasysh dhe përcaktimet ligjore dhe destinacionin e përdorimit të këtij komisioni. Sipas dispozitave, referuar me lart dhe dispozitave të ligjit nr. 10296, date 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Këshilli Drejtues është titullar i njësisë publike.
8. Në kuptim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.10296: “...Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike,

në mënyre të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientë ...”, përcaktohet qartë kompetencat që i linden Këshillit Drejtues për të përdorur këtë fond sipas dispozitave në fuqi.

Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP gjykon se:

9. Sipas pikës 3 të Udhëzimit nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar, AKEP ngarkohet të veprojë si agjent tatimor dhe për rrjedhojë duhen marrë masat organizative më qëllim përmirësimin e kushteve të punës të AKEP, në funksion të mbledhjes të tarifës për shërbimin e radiokomunikimit.
10. Përgjegjësitë dhe detyrat e AKEP si agjent tatimor dhe përdorimi i komisionit të përfituar sipas pikës 6 të Udhëzimit nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e Radiokomunikacionit”, i ndryshuar, burojnë nga përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë qëllim, konkretisht në pikën 4, neni 2, dhe pikën 3, neni 8, të ligjit nr. 9975, si dhe seksioni 1.3, Udhëzim nr. 27, datë 16.12.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar” .
11. E drejta e Këshillit Drejtues për të vendosur mënyrën, përdorimin me eficientë dhe në bazë të nevojave, duke marrë parasysh edhe përcaktimet ligjore dhe destinacionin e përdorimit të këtij komisioni, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të veprimtarisë si agjent tatimor të AKEP, bazohet në pikën 1 dhe 3, neni 114, si dhe bazuar në pikën 22, të nenit 4, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë e përcaktojnë kufijtë e përdorimit të nivelit të shpenzimeve.
12. Në kuptim të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 10296, “... *Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyre të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe eficientë ...”, përcaktohen qartë kompetencat që i linden Këshillit Drejtues për të administruar këtë fond sipas dispozitave në fuqi.*
13. Me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 93, datë 10.12.2018 “Për vendosjen e rregullave për mënyrën e buxhetimit, raportet e përdorimit dhe kompetencat e Këshillit Drejtues në miradministrimin dhe menaxhimin e komisionit të përfituar nga AKEP në cilësinë e tij si Agjent Tatimor, për mbledhjen e tarifave kombëtare”, është vendosur konkretisht, miratimi i rregullave për përcaktimin, menaxhimin dhe miradministrimin e komisionit të përfituar nga AKEP, në cilësinë e tij si agjent tatimor për mbledhjen e tarifave kombëtare.

14. Në vijim, me VKD nr. 93, është vendosur gjithashtu se Kryetari i Këshillit Drejtues, në cilësinë e tij si Drejtues Ekzekutiv i AKEP, i propozon KD shumë të komisionit të përfituar nga AKEP në cilësinë e tij si agjent tatimor për mbledhjen e tarifave kombëtare dhe, pas miratimit nga KD, Kryetari, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, ngarkohet të ndjekë procedurat zbatuese ligjore e nënligjore. KD është përgjegjës për të përcaktuar procedurën e miratimit të përdorimit të këtij fondi, përfshirë raportet e përdorimit, afatet/kohën se kur duhet të kryhen investimet/marrë punonjës të rinj apo shpërndahen komisionet e përfituar për vështirësi pune, në cilësinë e AKEP si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës kombëtare të radio komunikimit.
15. Këshilli Drejtues i AKEP, në referim të dispozitave ligjore të lartpërmendura, si dhe duke analizuar nevojat dhe duke parë përparësitë për përdorimin e komisionit të përfituar si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radiokomunikimit, vlerëson tërësisht legjitime dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi përdorimin e komisionit në fjalë, me qëllim përmirësimi të kushteve të punës të punonjësve dhe institucionit si dhe motivimit të punonjësve në kryerje e detyrës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1, të nenit 114, në pikën 1, të nenit 115, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Komisionet që parashikohen për t’u përfituara nga AKEP si agjent tatimor për mbledhjen e tarifës së radiokomunikimit, për vitin 2024, të përdoren:
 - a. për mekanizimin, informatizimin dhe përmirësimin e kushteve të punës të AKEP, në masën 40 % të vlerës së parashikuar;
 - b. në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në masën 60 % të vlerës së parashikuar.
- 2 Ngarkohet Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të pasqyrojë këtë vendim në projektbuxhetin e vitin 2024.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Armer Juka	Bleron Dokle	Lorenc Bako